



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:058868  
Datë: 19.09.2024  
Numri i dokumentit: 06181880

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0504-A0001

*Paditësi/Ankues*

M M fshati C, Gjilan

**Kundër:**

*E paditura*

**N.SH. N.H.N.I “Morava e Binçës”** (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-21-0232, të datës 16 gusht 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 19 shtator 2024, lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-21-0232, i datës 16 gusht 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 30 shtator 2013, paditësi kishte parashtruar një padi kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI037-0406 të datës 4 shtator 2013 dhe GJI037-0410 të datës 30 gusht 2013. Me vendimin GJI037-0406 të datës 4 shtator 2013 kërkesa e paditësit për kompensim për tre paga të papaguara në shumën prej 750.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak se sipas vlerësimit të Autoritetit të Likuidimit ishte konstatuar se në muajt e fundit para privatizimit të N.SH-së, parashtruesi i kërkesës nuk ishte një punonjës aktiv i N.SH-së dhe sipas listës së pagave kishte rezultuar se i njëjti nuk ka ofruar shërbime pune për ndërmarrjen. Gjithashtu me vendimin GJI037-0410 të datës 30 gusht 2013, kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,500.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme për arsyen e njëjtë si vendimi i lartcekur.

Në padi paditësi kishte theksuar se të njëjtit gabimisht dhe pa dëshirën e tij i është ndërprerë marrëdhënia e punës, se i njëjti i është bërë shoqërisë problem social duke u shndërruar në lypës pa asnjë anëtar të familjes të punësuar, me ç' rast i janë paraqitur edhe shumë sëmundje të ndryshme dhe momentalisht nuk ka mundësi të përkthej dokumentet nga shqip në anglisht. I njëjti në fund kishte shpresuar se kërkesa e tij do të pranohet pozitivisht. Padisë i ka bashkëngjitur këto prova: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI037-0406 të datës 4 shtator 2013 dhe GJI037-0410 të datës 30 gusht 2013, kopja e librezës së punës së paditësit, një Aktvendim për caktimin e vendi të punës me nr. 56/75 të datës 3 korrik 1975, kopjen e letërnjoftimit të paditësit, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës 9 maj 2008, një vendim të N.SH-së me nr. 760/3 të datës 3 dhjetor 2003, padinë e dorëzuar në DHPGJS si dhe një kërkesë nga paditësi drejtuar AKP-së të datës 15 shkurt 2011.

Me datë 6 nëntor 2017, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka specifikuar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimeve duke shkelur kështu nenin 70 paragrafi 2 i Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për AKP-në. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit se AKP-ja ka kërkuar që ish punëtorët të plotësojnë formularët e kërkesave dhe më tej i ka refuzuar kërkesat e tyre, pala kundërshtare mban qëndrimin se AKP-ja me likuidimin e N.SH-së ka njoftuar palët e interesuara mbi mundësinë e dorëzimit të një kërkesë në likuidim. Ndryshe nga sa ka deklaruar parashtruesi,

AKP-ja nuk e ka kërkuar këtë si detyrim por e ka parashtruar si mundësi për mbrojtjen e të drejtave të secilës palë të interesuar. Duke i pasur parasysh këto që u thanë, AKP-ja i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa si e papranueshme dhe të vërtetohet vendimi i AL-së. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur kërkesën për emërim të anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të datës 12 gusht 2016.

Me datë 17 dhjetor 2020, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-13-1906 kishte aprovuar kërkesën e paditësit për rishikimin e vendimeve si të bazuar, duke shfuqizuar vendimet e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe duke obliguar të njëjtin që t'i rishqyrtoj kërkesat kreditore të parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi ishte theksuar se asnjë punëtor apo kreditor potencial nuk mund t'i realizoj të drejtat e tyre kreditore ndaj një N.SH pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP-së dhe referenca si ajo se parashtruesi nuk ka iniciuar rast ligjor konsiderohet i papranueshëm. AKP-në e kishte obliguar që në rastin konkret lidhur me kërkesën kreditore të ankuesit të vendos në merita e jo edhe ta refuzoj si të pavlefshme për shkak të arsyeve të dhëna si në vendime.

Me datë 5 janar 2021, AKP-ja (ankuesja) kishte paraqitur ankesë kundër Aktvendimit C-IV-13-1906 të datës 17 dhjetor 2020 (Aktvendimi i ankimuar), në të cilën kishte theksuar se DHPGJS ka juridiksion vetëm për të verifikuar ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit. AL kishte ftuar DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në rishqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e AL-së që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime AL është i obliguar që t'i zbatoj ex officio. Andaj, i kishte propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktvendimin e ankimuar dhe të vërtetoj vendimet e AL-së, duke refuzuar ankesën e paditësit ndaj këtyre vendimeve. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të datës 30 shtator 2019.

Me datë 9 dhjetor 2021, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me Aktvendimin AC-I-21-0004-A0001 kishte aprovuar ankesën e AKP-së si të bazuar, duke anuluar Aktvendimin e ankimuar të shkallës së parë të DHPGJS-së dhe kishte dërguar lëndën në rigjykim në shkallë të parë tek gjyqtari përkatës. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi ishte theksuar se aktvendimi i ankimuar nuk ka mbështetje ligjore për të dërguar në rishqyrtim tek AL e AKP-së vendimet e Autoritetit të Likuidimit, pra nuk është arsyetuar se në bazë të cilës dispozitë mund të kthehet në rishqyrtim tek AL një kërkesë kreditore dhe në cilat kushte.

Me datë 21 qershor 2023, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësi nga i cili kishte kërkuar që të parashtrij të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën dhe një listë të provave që dëshmojnë se N.SH-ja i ka mbetur borxh tri paga në shumë prej 750.00 euro, me ç' rast paditësi kishte bashkëngjitur listën përfundimtare të punëtorëve.

Me datë 16 gusht 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-21-0232 kishte aprovuar kërkesën e paditësit dhe kishte vërtetuar vendimin e AL-së me nr. GJI037-0406 të datës 4 shtator 2013 me të cilin është refuzuar kërkesa e ankuesit për kompensimin e tre pagave të papaguara dhe kishte shfuqizuar vendimin e AL-së me nr. GJI037-0410 të datës 30 gusht 2013, me të cilin është refuzuar kërkesa e ankuesit për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, duke obliguar të paditurën që ankuesit në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës t'i paguaj shumën prej 1,500.00 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 6% të shumës themelore prej 90.00 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se në rastin konkret ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara si dhe nuk ka ofruar dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Për më tepër i njëjti ka dështuar të dorëzoj prova relevante edhe pas urdhrit të lëshuar nga gjykata. Sa i përket kërkesës së paditësit për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, gjykata kishte vlerësuar se ankuesi ka ofruar dëshmi relevante që dëshmojnë se i njëjti ka qenë punëtor i ndërmarrjes në fjalë në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP-së. Libreza e punës, Njoftimi dhe lista e punëtorëve e publikuar nga AKP-ja argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor i N.SH-së deri në ditën e privatizimit të saj, respektivisht 9 maj 2008, përkatësisht se ankuesi ishte punëtor i regjistruar me të drejtë legjitime pranë N.SH-së me rastin e përfitimit të një pjese të të hyrave nga 20% nga privatizimi i N.SH-së. AKP-ja asnjëherë nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankuesit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohohet drejta në kompensimin e pagave për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Me datë 4 shtator 2023, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë ndaj Aktgjykimit C-IV-21-0232 të datës 16 gusht 2023 (aktgjykimi i ankimuar), duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke refuzuar ankesën e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe duke vërtetuar këtë të fundit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë se ekzistojnë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit e

ka për obligim t'i pranoj dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëj me "Afatin për parashtrimin e kërkesave" që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurë të likuidimit dhe afati i dytë që ka të bëj me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Dy afatet e lartcekura janë të ndara dhe të dallueshme dhe një kreditor duhet t'i përmbushë të dy afatet në mënyrë të kërkesa e tij të pranohet. Andaj, Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj ex officio. Andaj, Kolegjit të Apelit i kishte propozuar si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 11 mars 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës në të cilën i kishte propozuar Kolegjit të Apelit që të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar dhe të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesat e paditësit për kompensimin e tre pagave të papaguara në shumën prej 750.00 euro si dhe për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,500.00 euro, ishin refuzuar si të pavlefshme nga ana e AL-së për shkak se ishte konstatuar se në muajt e fundit para privatizimit të N.SH-së, parashtruesi i kërkesës nuk ishte një punonjës aktiv i N.SH-së dhe sipas listës së pagave kishte rezultuar se i njëjti nuk ka ofruar shërbime pune për ndërmarrjen.

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur këto prova në mbështetje të ankesës së tij: kopja e librezës së punës së paditësit, një Aktvendim për caktimin e vendit të punës me nr. 56/75 të

datës 3 korrik 1975, kopjen e letërnjoftimit të paditësit, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës 9 maj 2008, një vendim të N.SH-së me nr. 760/3 të datës 3 dhjetor 2003, padinë e dorëzuar në DHPGJS si dhe një kërkesë nga paditësi drejtuar AKP-së të datës 15 shkurt 2011.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin e kishte aprovuar ankesën e paditësit si pjesërisht të bazuar, duke refuzuar ankesën për pjesën lidhur me paga të papaguara në mungesë të provave, ndërsa e kishte aprovuar sa i përket pjesë lidhur me të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shumën prej 1,500.00 euro, pasi që i njëjti kishte dorëzuar prova relevante si kopjen e librezës së punës dhe njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kontratën e punës.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se sa i përket pjesës së kërkesës lidhur me paga të papaguara, ankuesi në rastin konkret ashtu siç me të drejtë e thekson edhe shkalla e parë nuk ka ofruar asnjë dëshmi relevante në mënyrë që të vërtetoj se të njëjtit i takojnë pagat e papaguara të pretenduara.

Tutje, sa i përket pjesës së kërkesës për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, Kolegji i Apelit vëren se nga kopja e librezës së punës së paditësit shihet që i njëjti kishte ofruar shërbime për N.SH nga data 18 shtator 1973 deri me 9 maj 2008, kur të njëjtit i është mbyllur librezja e punës, pra në kohën e privatizimit të N.SH-së që do të thotë se marrëdhënia e punës së paditësit ka përfunduar si rezultat i veprimit/vendimit të AKP-së.

Gjithashtu nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit i datës 9 maj 2008, i cili është i bashkëngjitur në prova në shkresa të lëndës, shihet që paditësit i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë. Ky njoftim në përmbajtjen e tij thekson se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*.

Prandaj, paditësi duke vepruar konform njoftimit që i është bërë, ashtu siç theksohet edhe në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit për dorëzimin e kërkesave kishte paraqitur kërkesën për kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ashtu siç ishte njoftuar nga AKM-ja.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra se i njëjti nuk ka ofruar shërbime për N.SH apo se të njëjtit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i veprimit/vendimit të AKP-së. Për me tepër e paditura nuk kishte kontestuar as lartësinë e shumës se kërkuar.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,500.00 euro dhe e kishte refuzuar ankesën e paditësit lidhur me pjesën e kërkesës për paga të papaguara në shumën prej 750.00 euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 9 tetor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 19 shtator 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_